



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 195/6 prot.

Tiranë, më 04.05.2020

URDHËR
Nr. 37, datë 04.05.2020

PËR
“RIHAPJEN E AFATIT TË APLIKIMIT PËR ANËTAR TË KOMISIONIT
INSTITUCIONAL ZGJEDHOR NË UMT”


Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe këkrimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nr.36, datë 17.03.2020 “Për publikimin e kërkesës për aplikim për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese...”, ndryshuar me urdhrin nr.99, datë 26.03.2020, si dhe në mbledhjen e Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zvilluar më 04.05.2020,

URDHËROJ:

1. Të vijohet me rihapjen e afatit të aplikimit për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas Formularit për Aplikim dhe Formularit të Vetëdeklarimit, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademi nr.36, datë 17.03.2020 “Për publikimin e kërkesës për aplikim për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si anëtarë i Komisionit Institucional Zgjedhor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, **do të jetë deri më 08.05.2020.**
3. Dokumentacioni përkatës dorëzohet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UMT-së, në rektoratin e UMT-së, **në harkun kohor 09:00 – 16:00.**
4. Dekanët e Fakulteteve të UMT-së, të marrin masat për njoftimin e të gjithë personelit akademik të fakulteteve të UMT-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

REKTORI
ARBEN GJATA




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2020

FORMULAR APLIKIMI

PËR
ANËTARË TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR TË UNIVERSITETIT TË
MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të nenit 6 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga senati Akademik i UMT-së me vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores ..”

Unë i/e nënshkuara Z./ Znj. _____, personel akademik pranë Fakultetit të _____, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, paraqes aplikimin tim për të qenë anëtar i Komisionit Institucional Zgjedhor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për procesin zgjedhor të shpallur me Urdhrin nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë” në respektim të Rregullores së sipërcituar.

Në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma c), deklaroj se nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe/ose as për anëtar në organet drejtuese të çdo niveli, si dhe përmbush kriteret e mëposhtme sipas dokumentave bashkëlidhur:

- a. Jam personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- b. Nuk kam qënë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- c. Kopje e ID;

Aplikues:

Emër, Mbiemër, Firmë

Kjo fletë aplikimi duhet të depozitohet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Zyra e Sektorit të Prokurimeve, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Mbiemri, emri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam i/e padënuar i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARUESIT

Emër, mbiemër/firmë

Emër, mbiemër/firmë/vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

